

Akti i Themelimit

“SIRIUS RC”

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot, më 04.04.2022 i nënshkruari:

- Z. Albion Bostani, i biri i Thoma Bostani dhe Gelardina Bostani, i lindur më 10/08/1993 në Fier, Shqipëri dhe banues në adresën Rruga Babe Rexha, 1 Shtyllore, 1265 Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J30810081M
- Znj. Suela Ereqi, e bija e Skender Ereqi dhe Luljeta Ereqi, e lindur më 21/04/1995 në Fier, Shqipëri dhe banuese në adresën Rruga Artan Lenja 61, Tiranë me kombësi Shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit me numër J5421077Q

Me vullnetin tonë të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (Ligj i Shoqërive) kemi vendosur të krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “SIRIUS RC” (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Emri dhe forma ligjore

Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë “SIRIUS RC” ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi “sh.p.k., cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” (Ligji i Shoqërive

Selia dhe kohezgjatja

Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Rruga L”Sheq i Madh”, Nr. Pasurie 155/48, Ndërtesë dy katëshe, Zona kadastrale Nr. 3981, Fier. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar

dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

Objekti i veprimtarisë

Neni 3.

- 3.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor kryerjen e procedurave të punësimit profesional për palë të treta si dhe shërbime të tjera të ngjashme si: Agjenci ndërkombëtare punësimi, edukimi dhe formimi profesional. Shërbim konsulence dhe ndërmjetësimi emigracioni, për studime, trajnime dhe formim profesional brenda dhe jashtë vendit, Shërbim i praktikave profesionale të punës dhe mësimore brenda dhe jashtë vendit, Ofrim i shërbimit të konsulencës, të asistencës teknike dhe logjistike për aplikimet për vizë, leje pune dhe leje qëndrimi për të huajt.
- 3.2 Shoqëria mund të bëjë të gjitha operacionet tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të pasurive të paluajtshme, financiare dhe të kredisë pa kufizim shume, të nevojshme apo të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, apo që sidoqoftë kanë ngjashmëri me qëllimin e shoqërisë. Shoqëria mund të marrë kuota apo pjesëmarrje në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm ose të ndryshëm. Te marrë financime nga institute të ndryshme kredie, edhe nga shoqëri të tjera shtetërore apo private, duke dhënë garancitë e nevojshme imobiliare, reale dhe personale.

Kapitali themeltar dhe ndarja e tij

Neni 4.

- 4.1 Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri janë si mëposhte:
- Z. Albion Bostani në cilësinë e ortakut të shoqërisë, mbajtës i kartës së identitetit me numër J30810081M, zotëruar i një kuote të barabartë me vlerë nominale 50%.
 - Znj. Suela Ereqi në cilësinë e ortakut të shoqërisë, mbajtëse e kartës së identitetit me numër J55421077Q, zotëruar i një kuote të barabartë me vlerë nominale 50%.
- 4.2 Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 120.000 (Njëqind e njëzet mijë) Lek, i ndarë në 2 (dy) kuota, me një vlerë nominale prej 60.000 (Gjashtëdhjetë mijë) Lek, plotësisht të nënshkruara nga Ortakët themelues.

Organet drejtuese dhe Administrimi

Neni 5.

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:
- Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
 - Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë: Z. Albion Bostani i cili e merr këtë detyrë për një periudhë 1 (një) vjecare me të drejte rinovimi.

Dispozita Përfundimtare

Neni 6.

- 6.1 Cdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 6.2 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Akt Themelimi ose për shkak të ligjit, palët do të përpiqen të zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e palëve do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së parë Tiranë.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërisë, sot më datë 04.04.2022 gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje.

ORTAKET THEMELUES

Znj.Suela Ereqi

Z. Albion Bostani

04/04/22 Tiranë, 
(Data, vendi, firma)

04/04/2022 Tiranë
(Data, vendi, firma)

